

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gazetari Gjinaj: 'Dosja e SHISH' nuk mbyllet me 3 të akuzuarit, Hyseni dha një tjetër provë në SPAK
ADRESA	https://piranjat.al/politike/gazetari-gjinaj-dosja-e-shish-nuk-mbyllet-me-3-te-akuzuarit-hyseni-dha--i105899
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 18:09:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 18:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	71ea3cbc53b1895188625711a7af4bbbc6ce819e8d1b2f20c5ce5eb98fcd777d
TEKSTI	6a75242b56a66b27b7affd0601bb99a295a4aea196d60298416ea75b02c25b67
PAMJA	9a74c5d16628d59e5a4363529b15d91b17350851d0c9f3d5bd34635ca42b8321

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	56fc69191790b717fcf3ba33131248f8a7e9ee76f99c00dc2ac7b9668ae15fdb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1385e7008e03de6abe2f8860ad6394539ccdddc8b72b1ba567a2f7f8b6825304
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/56fc69191790b717fcf3ba33131248f8a7e9ee76f99c00dc2ac7b9668ae15fdb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **kanabisit në Shqipëri** fundit, duke sekuestruar ■ **re per naftën/ Efekti** euro të tjera në vit barra fiskale nga ■ **ndodhi në Sarandë** e cila nuk ■ **e gazetares Vjollanda Peca nga** e cila gjatë protestës së zhvilluar sot në ■ transf... ■ **pen...**

POLITIKE

Gazetari Gjinaj: 'Dosja e SHISH' nuk mbyllet me 3 të akuzuarit, Hyseni dha një tjetër provë në SPAK

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 20:05

LSAPHOTO.COM



Gazetari Fatjon Gjinaj, i ftuar në Edicionin 'Ora 19' me moderatoren Armela Ferko në SYRI TV, ka folur për zhvillimet e fundit lidhur me dosjen hetimore ku është e përfshirë edhe drejtorja e Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni.

Gjinaj tha se seanca gjyqësore për rivlerësimin e masave të sigurisë u zhvillua me dyer të mbyllura dhe zgjati më shumë se dy orë. Sipas tij, pjesa më e madhe e seancës iu kushtua Hysenit, ndërsa për dy personat e tjerë të akuzuar u zhvillua një proces më vete.

'Vlora Hyseni nuk ka pranuar të mbajë ndonjë qëndrim konkret. Pjesa më e madhe e seancës, prej më shumë se dy orësh, është dedikuar posaçërisht për të', tha Gjinaj.

Sipas gazetarit, Hyseni dhe avokati i saj e kanë shfrytëzuar seancën për të lexuar aktet dhe për t'u njohur me dosjen hetimore, përpara se të mbajnë një qëndrim. Mbrojtja ka kërkuar një masë më të butë sigurie, duke e konsideruar të panevojshme masën e kërkuar nga organi i akuzës. Nga ana tjetër, prokurorët kanë insistuar se provat e administruara janë ato që kanë bindur gjykatën për vendosjen e masave të sigurisë dhe se janë të gatshëm të paraqesin materiale e referenca për bazën e akuzave.

'Sot kemi parë shumë pak ngulmë nga avokatët ose gjyqi, për shkak se ajo është në dyer të mbyllura, bëhet rivlerësimi i masave dhe marrja në pyetje. Vlora Hyseni nuk ka pranuar të mbajë ndonjë qëndrim konkret, pjesa më e madhe e seancës prej më shumë se dy orësh është e dedikuar posaçërisht për të, sepse për dy të akuzuarit e tjerë u bë një proces në vete.

Është shfrytëzuar nga Hyseni dhe avokati i saj për të lexuar aktet dhe për të parë dosjen hetimore që në fund të mbajnë një qëndrim. Është kërkuar një masë më e butë, është konsideruar e panevojshme masa nga avokatët, por prokurorët kanë insistuar që këto prova janë ato që kanë bindur gjykatën për të ndërmarrë masat e sigurisë dhe për çdo tjetër pretendim janë të gatshëm për të dhënë materiale dhe referenca se ku është bazuar akuzat e ngritura ndaj tyre.

Për ta përmblodhur dosja akti 2, ose mua më... e kam preferuar ta quaj dosja e SHISH-it.

Sepse ka si protagonist kryesor drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror dhe nuk ndodh shpesh në Shqipëri, nuk ndodh që nuk ndodh, por edhe në botë që kryeinteligjenca, ta quajmë kryespiunja, kryehetuesja apo kryeagjentja të jetë në bankën e të akuzuarve. Por mund të them që kjo dosje nuk do të mbyllet me këta tre persona që janë akuzuar, si zonja Hyseni, administratori i një biznesi në Durrës apo shefi i laboratorit të policisë shkencore, sepse ka të dhëna që ende nuk janë apdetuar dhe nuk janë verifikuar në mënyrë shteruese nga ana e agjentëve të SPAK-ut.

Janë dinamike. Ka të dhëna që ende nuk janë verifikuar, që janë mbledhur gjatë procesit hetimor. Kujtojmë Armela që në datë 18 shtator, pra vetëm 5 ditë përpara se të bëhej ekzekutimi i masave të sigurisë, Vlora Hyseni ka ngjitur shkallët e prokurorisë, që do të thotë i është marrë një provë tjetër teksa kërkesa për arrestimin e saj ndodhej në gjykatë dhe gjykata ende nuk ishte shprehur. Pra edhe gjatë fazës që ka qenë procesi hetimor në zhvillim e sipër, gjykata ishte drejt një vendimmarrjeje, të pranonte apo të mos pranonte kërkesën e SPAK për tre masa sigurimi, dy prej të cilave arrest në burg dhe një arrest shtëpie, si dhe për Hysenin bashkëshoqëruese me arrestin e shtëpisë, pezullimi nga detyra.

Pra, që do të thotë se veprimet hetimore për këtë dosje janë intensive dhe do të prodhojnë më të vërtetë lajme. Natyrisht, media dhe gazetarët lajme duan, por janë lajme të trishta, janë lajme të rënda, janë lajme tronditëse për sigurinë dhe stabilitetin e një vendi.

Dhe më lejoni të them, sepse gjatë komunikimeve dhe raportimeve tona jemi të detyruar të mbajmë atë standardin e raportimit, por e kemi të lirshëmërinë tashmë nga divani apo kudo tjetër', u shpreh Fatjon Gjinaj në SYRI TV.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 24 Shtator19:44

[Aktivistja: Dejtoresha e SHISH i jepte informacione Ergys Agasit për t'i shpëtuar policisë! Protestuesit i arrestojnë dhunshëm](#)

Ka nisur përballë godinës së Kryeministrit protestë e radhës kundër qeverisë, ku qytetarë dhe aktivistë janë...

POLITIKE 24 Shtator19:40

[FOTO/ Klodiana Spahiu vendos censurë, për daljet në media mjekët dhe infermierët duhet të marrin miratim](#)

Qendra Spitalore Universitare 'Nënë Tereza' (QSUT) ka vendosur një procedurë të re për daljet publike të stafit...

POLITIKE 24 Shtator19:23

[Tabaku: Kërcënimi ndaj Klodiana Lalës tregon shtetin privat. Ky sistem duhet çmontuar](#)

Deputetja e Partisë Demokratike dhe kryetarja e Komisionit për Median dhe të Drejtat e Njeriut, Jorida Tabaku, reagoi pas incidentit në ambi...

POLITIKE 24 Shtator19:02

[“SPAK e ka të pamundur të mos e thërrasë Ramën”/ Çollaku: Vlora Hyseni përdorte numra serbë e rusë](#)

Në vijim të analizës së tij për tronditjen e institucioneve të inteligjencës pas arrestimit të ish-drejtuës së SH...

POLITIKE 24 Shtator18:59

[‘PS rrëzoi kërkesën e PD për rastin e ish-drejtores së SHISH-it’/ REL: Berisha kërkoi dorëheqjen e Edi Ramës](#)

Gjykata e Posaçme vendosi vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj ish-drejtuës së Shërbimit Informativ të Shtetit (...)

POLITIKE 24 Shtator18:51

[‘Kryemerimanga në New York’/ Koka: Rama në qendër të skandalit të SHISH dhe përfitimit politik në zgjedhje](#)

Gazetari Bledian Koka, në emisionin “Task Force” në Syri TV me Sonila Meçon, ngriti akuza të forta ndaj kryeministrit Edi Rama...

POLITIKE 24 Shtator16:01

[Sulmi i Vlorë Hysenit ndaj gazetares Klodjana Lala, reagon Gazment Bardhi: Balta dhe shpifjet nuk zëvendësojnë transparencën](#)

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazmend Bardhi ka reaguar lidhur me sulmin e ish-drejtoreshës së SHISH, ndaj gazetares Klodiana Lala. P&...

POLITIKE 24 Shtator15:02

[“Historia rozë Agasi-Hyseni për të spostuar vëmendjen! Shteti ka rënë!”, Boçi për sulmin e Vlorë Hysenit ndaj gazetares Lala: Presion!](#)

Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi, ka reaguar për sulmin e ish-drejtuës së SHISH, Vlorë Hyseni, ndaj gazetares së News24, Klo...

POLITIKE 24 Shtator14:55

[Skandali në SHISH/ Luçiano Boçi: Vlorë Hyseni para drejtësisë, përgjegjësi politike e Ramës! PS e mbuluar nga skandalet](#)

Në një intervistë në “Minuta e Parë” në News24 Luçiano Boçi është shprehur kritik ndaj kryem...

POLITIKE 24 Shtator14:04

[Berisha: SHISH ka përgjuar gazetarë, Vlorë Hyseni mund të shantazhojë edhe prokurorë e gjyqtarë](#)

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, duke folur jashtë ambienteve të Kuvendit ka reaguar për sulmin e ish-shefes së Shë...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

[U vra nga pronari italian i banesës, del autops...](#)

Pak ditë pas vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar Gjovalin Lazri nga pronari italian i një banese, mediat italiane japin të tjera detaje p...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...](#)

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një eum...

"Ergys Agasi filmente video gjatë takimeve në z..."

Gazetarja Anduena Llabani, ndau detaje të tjera në lidhje me hetimet e SPAK-ut në dosjen ku është përfshirë edhe drejtoresha ...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator 11:40

EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.